



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:146150
Datë: 26.01.2022
Numri i dokumentit: 02646321

Ac.nr.10274/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi- kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Bujar Muzaqi anëtarë, në çështjen juridike të paditëses-propozueses D.M nga Prishtina, “.....”, ”.....” të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson F.SH, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës-kundërshtarës së sigurimit Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës-Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës, me seli në Prishtinë, Qyteza Pejton, Rruga “Perandori Justinian”, Nr. 71, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Ali Dragusha, Zyrtar i Lartë Ligjor, lidhur me çështjen juridike propozimi i caktimit të masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditëses-propozueses, të paraqitur, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5901/21, i datës 04.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditëses-propozueses së sigurimit D.M nga Prishtina, “.....”, “....”, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5901/21, i datës 04.11.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.5901/21, të datës 04.11.2021, e ka hedhur poshtë padinë dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit e paditëses-propozueses të masës së sigurimit, D.M nga Prishtina”.....”, “....”, kundër të paditurës-kundërshtarës së sigurimit Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës-Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës, me seli në Prishtinë, Qyteza Pejton, Rruga “Perandori Justinian”, Nr. 71, lidhur me çështjen juridike vërtetim i pronësisë së banesës me numër “.....” e cila gjendet në rrugën ish “Ramiz Sadiku”, tani “Agim Ramadani”, kati i parë, hyrja 4, numër

36, në Prishtinë, si të pa lejuar.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditëses-propozueses të sigurimit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, t'a aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën, ta ndryshojë aktvendimin e atakuar duke e vendosur masën e sigurisë dhe duke aprovuar pjesën që ka të bëjë me bazushmërinë e kërkespadiës, po ashtu të detyrohet e paditura t'ia kthejë çelsat paditëses dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe përfaqësimit sipas TA.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të paditëses-propozueses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja-propozuesja e masës së sigurimit D.M nga Prishtina, fillimisht përmes padisë-propozimit për caktimin e masës së përkohshme të datës 30.10.2020 ka kërkuar nga gjykata të aprovohet kërkesëpadija e paditëses dhe të vërtetohet se paditësja është pronare e banesës si dhe të anulohet njoftimi lidhur me lëndën 011-463-2/425/20 i datës 14.07.2020 të anulohet aktvendimi për caktimin e vërtetimit numër 011-463-2/425/20 i Agjencisë Kadastrale si dhe të anulohet vendimi HPCC/D/226/2005/A-C, i datës 22.10.2005, ndërsa me propozim për masë të sigurisë ka kërkuar nga gjykata caktimin e masës së sigurimit me të cilën t'i ndalohet të paditrës-kundërshtares së sigurimit ekzekutimi i vendimit HPCC/D/226/2005/A-C, i datës 22.10.2005 dhe njoftimit për lirim të pronës me shenjën trashigimisë me numër të vendimit O.nr.22/94 ishte shpallur trashëgimtarë. Gjithashtu paraardhësja e kësaj prone L.B ishte bërë pronare sipas vendimit të Ndërrmarrjes Publike banesore numër "....." i datës 24.09.1992 ku pastaj ajo kishte lidhur kontratën me numër 1193/2784 e të gjitha këto lidhur me të drejtën e pronësisë.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqjese, duke vepruar sipas propozimit të paditëses-propozueses të sigurimit me aktvendimin e atakuar C.nr.5901/21, i datës 04.11.2021, e ka hudhë poshtë padinë dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të ushtruar nga paditësja-propozuesja si të pa lejuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së Apelit të Kosovës të aktvendimit CA.nr.4962/21 të datës 21.07.2021, duke vlerësuar se nga shkresat e lëndës dhe deklaratimet e palëve ndërgjyqjese nuk ishte kontestuese se me vendimin Nr.HPCC/D/226/2005/A&C, i dt.22.10.2005 dhe vendimin mbi kërkesën për rigjyqrim Nr.HPCC/REC?101/2008, të datës 19.06.2008 në mes të paraqitësit të kërkesës së kategorisë "A" DS002241 Halit Sinani dhe paraqitësit të kërkesës së kategorisë "C" DS001970, është zhvilluar një procedurë të e paditura, si institucion i autorizuar me ligje, për vlerësimin e kërkesave që ndërliken me shqyrtimin dhe vendosjen mbi kërkesat pronësoresh juridike për posedimin dhe administrimin e tyre, për pronar bujqësorë dhe komerciale që i referohen vitit 1999, për personat e shpërngulur nga lufta, pra me ligj Agjencia ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e palujtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën

private komerciale si dhe krahasimin e zgjidhjen e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare. Me dispozitat kalimtare të Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës Ligji Nr.05/L-010, përcaktohet se pjesë të mandatit dhe përgjegjësi të Agjencisë Kosovare të Pronës – tani e paditur, kryesisht ato pjesë që kanë të bëjnë me implementimin e vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësor Banesore si dhe pronave që aktualisht janë nën administrimin e AKP-së. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, asetet fizike, obligimet kontraktuale dhe ato buxhetore të Agjencisë Kosovare për Prona nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore, ka për obligim zbatimin e vendimeve të saj edhe përkundër ndyrshimit të mandatit me ligjin e ri. Pra siç është vërtetuar nga vendimi Nr.HPCC/D/226/2005/A&C, i dt.22.10.2005 dhe vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim Nr.HPCC/REC/101/2008, të datës 19.06.2008, është aprovuar kërkesa e kategorisë “C” DS001970, në formë të kompensimit, ku palër përkatëse janë njoftuar mbi vendimin e komisionit dhe janë pranuar dy kërkesa për rishqyrtim, njëra paraqitësi të kërkesës së kategorisë “C” R.D dhe tjetra nga banuesja aktuale e pronës së kërkuar Drita Morina, e cila e kishte blerë pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës së kategorisë “C”.

Tutje, Gjykata ka arsyetuar se e ka detyruar të paditurën që gjykatës t’i dorëzoi vendimin HPCC/D/226/2005/A-C i dt. 22.10.2005, vendimin numër HPCC/REC/101/2008 të datës 19.06.2008, vendimin HPCC/d/KOMF/02/2019 i dt. 13.12.2019 si dhe veprimet tjera të ndërrmarra nga e paditura, të cilat vendime e paditura gjykatës i ka dorëzuar me parashtresë dhe gjykata pasi që i ka shqyrtuar këto shkresa ka gjetur se me vendimin HPCC/D/226/2005/A&C, të datës 22.10.2005, janë vendosur kërkesat DS002241, e palës kërkuese Halit Sinani dhe kërkesa DS001970, e palës përgjegjëse R.D, sipas të cilit palës kërkuese H.S, i ishte e njohur e drejta pronësore në banesën lëndore e cila gjendet në Prishtinë, në Rrugën ”.....”, në sipërfaqe prej 30.59m², ndërsa palës tjetër e drejta e kthimit – kompensimit të çmimit blerës të saj, që të dyve nën kushte të caktuara ligjore si në pikat tjera të vendimit. Gjykata vendosi duke u bazuar në dispozitat e nenit 391 paragrafi 1, pika c) dhe d) nenit 393 dhe nenit 166 paragrafi 2 të LPK-së, e lidhur me nenin 1.2, 2.5 dhe 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut numër 1999/23 dhe nenit 17 dhe 19, të Ligjit 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës u vendosë si në dispozitiv aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrën të drejtë dhe të ligjshme kur e ka hedhur poshtë si të palejueshme padinë dhe propozimin e paditëses-propozueses

së ankesës, e paraqitur kundër aktvendimit të atakuar, për faktin se me dispozitën e nenit 262 paragrafi 2 të LPK-së përcaktohet se: “Sa i përket kërkesës të cilën pala e ka parashtruar gjatë zhvillimit të procedurës, gjyqëvarësia krijohet në momentin në të cilin është njoftuar pala kundërshtare për kërkesën e tillë”, ndërsa me paragrafin 3 përcaktohet se: “Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqëvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapë se prapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”, ndërsa me paragrafin 4 përcaktohet se: “Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta”.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i rregullt dhe i ligjshëm, për faktin se edhe sipas vlerësimit të kësaj në këtë çështje juridike kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se lidhur me padinë gjegjësisht çështjen e njëjte të paditëses-propozueses se sigurimit, është vendosur njëherë me aktvendimin e Gjykatës Supreme e Kosovës GJSK-KPA-A-004/2020 të datës 24.12.2020, me të cilin është hedhur poshtë si e pa lejshme ankesa e D.M, e parashtruar kundër Njoftimit DS002241, të datës 28.10.2020, lidhur me zbatimin e Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, HPCC/D/226/2005, të datës 22.10.2005. Në këtë kontekst kjo gjykatë vlerëson se një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë mbi hedhjen si të palejuar të padisë-propozimit është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që lidhur me këtë kërkesë është vendosur njëherë nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin GJSK-KPA-A-004/2020 të datës 24.12.2020, me çka edhe procedura është përfunduar, andaj në këtë situatë lidhur me atë kërkesëpadi nuk mund të vendoset dy herë pasi që është vendosur lidhur me të njëherë, andaj mbi këtë bazë gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka hedhur poshtë si të palejuar padinë dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të paditëses-propozuesës dhe në këtë drejtim pretendimet ankimore të paditëses u refuzuan si të pathemelta ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë.

Duke marr parasysh pretendimet ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e paditëses-propozueses, si e pathemeltë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të paditësve, mirëpo meqenëse të njëjtat nuk patën ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe, Gjykata e Apelit është rezervuar në dhënien e arsyeve që dalin jashtë vlerësimit për çështjes së trajtuar në këtë rastë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së

Numri i lëndës: 2020:146150
Datë: 26.01.2022
Numri i dokumentit: 02646321

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
Ac.nr. 1074/21, me datë 05.01.2022

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Nehat Idrizi, d.v